



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:039263

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05705656

C.nr.311/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.M., nga fshati ..., Komuna Ferizaj, me numër personal ..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. Masar Morina, nga Gjilani, kundër të paditurit Komuna Ferizaj, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi me autorizim S.V., me objekt kontesti vërtetim pronësie, vlera e kontestit 5,000 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datën 20.05.2024 përpiloj me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditëses L.M., nga fshati ..., Komuna Ferizaj, kundër të paditurit Komuna Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses dhe të vërtetohet se paditësja është pronare në bazë të posedimit me mirëbesim dhe trashëgimit e ngastrës kadastrale në sipërfaqe prej 4506 m², lloji i shfrytëzimit bujqësor, shfrytëzimi aktual kullosë e kualitetit të klasës së tretë, në vendin e quajtur "B.", ZK-P., Ferizaj, që është pjesë e sipërfaqes së tërësishme prej 12 mijë e 14 metra katror dhe evidentohet në emër të Komunës së Ferizajt, e të cilën gjë e paditura Komuna Ferizaj është e obliguar që ta pranoj dhe lejoj paditëses që tek organi kompetent i gjeodezisë në Ferizaj të regjistrohet si pronare e vetme e paluajtshmerisë, në të kundërtën ky aktgjykim paditëses do t'i shërbej si titull ekzekutiv për regjistrim.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja kundër të paditurit me datën 02.03.2021, ka ngritur padi me bazë juridike vërtetim pronësie. Në padi ka theksuar se paraardhësi i paditëses B.M.A. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, ka qenë pronar i parcelës kadastrale ..., me kultur kullosë dhe sipërfaqe prej 0.46.62 ha, në vendin e quajtur "B.", ZK-P., Ferizaj. Kjo pronë edhe përkundër faktit që është shfrytëzuar nga babai i paditëses nga viti 1949 e deri në vdekjen e tij më 20.01.1997, ku edhe ka ndërtuar shtëpinë e cila gjendet akoma si objekt gjysmë i rrënuar, pas vdekjes së tij çuditërisht dhe gabimisht e njëjta parcelë është evidentuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj, si pronë shoqërore komunale. Pas vdekjes së babait të paditëses si trashëgimtarë janë shpallur paditësja dhe motra e saj S.H., njëherit vajzat e të ndjerit B.A.. Të njëjtat, si trashëgimtare të vetme të ligjshme pas vdekjes së babait të tyre kanë tentuar që pranë Zyrës Kadastrale në Ferizaj të bëjnë bartjen e pronësisë, por që e kanë pas të pamundur që në procedurë administrative të realizojnë këtë të drejtë, me arsyetimin se nga shteti i Serbisë nuk janë kthyer të gjitha librat amëz në kadastër dhe se këtë të drejtë duhet kërkuar përmes gjykatës në procedurë kontestimore civile. Andaj, meqenëse kjo pronë është private, pasi që të gjitha pronat rreth saj kanë pronar privat, është mëse e qartë se ky gabim është bërë gjatë periudhës së vitit 1981 kur është bërë aeroincizimi i fundit i paluajtshmërive në Kosovë dhe se nuk kemi të bëjmë me kurrfarë baze tjetër të transferimit të kësaj prone në pronë shoqërore. Përfaqësuesi i paditëses gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor e ka precizuar kërkesëpadinë e paditëses, si dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses dhe të vërtetohet se paditësja është pronare në bazë të posedimit me mirëbesim dhe trashëgimit e ngastrës kadastrale në sipërfaqe prej 4506 m2, lloji i shfrytëzimit bujqësor, shfrytëzimi aktual kullosë e kualitetit të klasës së tretë, në vendin e quajtur "B.", ZK-P., Ferizaj, që është pjesë e sipërfaqes së tërësishme prej 12 mijë e 14 metra katror dhe evidentohet në emër të Komunës së Ferizajt, e të cilën gjë e paditura Komuna Ferizaj është e obliguar që ta pranojë dhe lejojë paditëses që tek organi kompetent i gjeodezisë në Ferizaj të regjistrohet si pronare e vetme e paluajtshmërisë, në të kundërtën ky aktgjykim paditëses do t'i shërbejë si titull ekzekutiv për regjistrim. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës

E paditura përmes përgjigjes në padi të datës 28.10.2022 ka theksuar se pretendimet e paditëses për fitimin e të drejtës së pronësisë me parashkrim fitues, nuk ka asnjë provë që mund të dëshmojë pronësinë, ku në nenin 29 të LMTHJP i cili ka qenë në fuqi deri në vitin 19.08.2009 është thënë se mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrim fitues. Paditësja asnjë dokument faktik nuk e ka ofruar si provë e cila do të shërbente për ndriçimin e çështjes se ka qenë dhe është pronare e ngastrës kadastrale kontestuese. Paditësja

asnjëherë nuk ishte mbajturë ligjor, i legjitimuar nga një bazë e vlefshme ligjore (jus titulus) për fitim të pronësisë. Pasi ekzistimi i të drejtës së pretenduar pronësore nuk është dëshmuar nga paditësja në pajtim me nenin 319 par.1 të LPK-së duhet të pranoj këtë të drejtë të pa dëshmuar të pretenduar jo ekzistuese dhe që këtej të refuzoj dhe të deklaroj ekzistimin e saj sipas nenit 254 par.1 të LPK-së. Për të gjitha këto arsye kërkesëpadia e paditëses është e pabazë. Përfaqësuesi i të paditurës gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar në tërësi të njëjtën si të pabazuar. Meqenëse toka është e regjistruar në pronë komunale nuk ka bazë juridike ligjore që të fitohet e drejta e pronësisë qoftë me parashkrim apo forma tjera. Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka bërë administrimin e këtyre provave: Certifikata e pronës me numër ...15 e datës 23.02.2015, e lëshuar nga Komuna Ferizaj, Formularët për kërkesa për ankesë i N.M. (djalinjtë të paditëses), Dëshmi vdekja e B.M.A., me numër 02.nr...., e lëshuar nga Komuna Ferizaj, Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur me datë 07.02.2015, Fleta poseduese e ngastrës ...-0 dhe fleta poseduese në kopjen e planit për ngastrën ...-1 e vitit 2015, ekspertiza gjeodezike së bashku me historiatin e parcelës kadastrale, si dhe 12 foto në flete A4 të parcelës kontestuese si dhe dëgjimi i paditëses L.M. në cilësi të palës dhe dy dëshmitarëve D.H. dhe F.R.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 7 dhe 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që ka gjetur se duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Me leximin e ekspertizës nga lëmi i gjeodezisë së punuar nga Dr.sc. M.L. nga Ferizaj, e datës 01.12.2023, vërtetohet se parcela ...-4 ZK P. me sip. prej 12014 m² me kulturë kullosë e klasës 3 është pronë me pronar Komuna e Ferizajit me pjesë të pronës 1/1. Kufizimi i pronës me pronat tjera: pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se pjesa e parcelës ...-4 ZK P. e cila është objekt kontesti kufizohet: - Në anën veriore në gjatësi prej 36.66 m kufiohet me parcelën ...-4-2 ZK P. dhe në gjatësi prej 96.55 m kufizohet me rrugë publike, në anën lindore në gjatësi prej 60.83 m kufizohet me pjesën e parcelës ...-4 ZK P., në anën jugore në gjatësi prej 9.42 m kufizohet me parcelën ...-13 në gjatësi prej 5.14 m kufizohet me parcelën 58-12, në gjatësi prej 34.48 m kufizohet me parcelën ...-11, në gjatësi prej 19.33 m kufizohet me parcelën ...-6 dhe në gjatësi prej 43.27 m kufizohet me parcelën ...-8 ZK P., në anën perëndimore në gjatësi prej

22.65 m kufizohet me pjesën e parcelës ...-4 ZK P.. Në pjesën e parcelës ...-4 ZK P. për të cilën është objekt kontesti ka të ndërtuar dy shtëpi-objekte të vjetra prej balte të pa banuara dhe pjesa tjetër është livadhë. Kurse pjesa e parcelës ...-4 ZK P. e cila është objekt kontesti për vërtetim pronësie ka sipërfaqe prej 4506 m2. Si shtojcë ja ka bashkangjitur: skicën e matjeve, fotot nga vendi i ngjarjes, historiatin e parcelës, ortofotot e viteve 2001, 2004, 2009, 2012 dhe 2018 dhe certifikatën e pronës. Përmes historiatit të parcelës së Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës së Ferizajt, rezulton se sipas gjendjes KCID azhurnuar të dhënat e viteve 83-88 parc. kad. me nr. ...-1 ZK P. evidentohet në emër të P.SH. KUVENDI KOMUNAL FERIZAJ. Numri i protokollit .../2023, data 05.09.2023, parcela kad. me nr. ...-1 është ndarë dhe janë krijuar parcelat kadastrale me nr. ...-3 dhe ...-4. Më pas, eksperti pasi që kishte përpiluar këtë ekspertizë, ishte ftuar për sqarime në gjykatë në seancën e datës 07.03.2024, ndërkaq palët ndërgjyqëse përkatësisht paditësja dhe i autorizuari i paditëses deklaruan se e kanë pranuar ekspertizën me kohë, ndaj ekspertit kanë pyetje dhe kërkojnë sqarime shtesë ndaj të cilave morën përgjigje. Gjykata i fali besimin e plotë kësaj ekspertizë gjeodezike, pasi që e njëjta ka pasqyruar në tërësi gjendjen faktike e për më tepër, as palët ndërgjyqëse nuk e kanë kontestuar dhe as që i kanë bërë vërejtje, e po ashtu edhe sipas konstatimit të gjykatës, e njëjta i përmban të gjitha elementet e nevojshme që duhet ti ketë një ekspertizë, e njëjta është dhënë mbi bazën e njohurive profesionale të ekspertit të cilën gjykata e vlerësoi si të drejtë. Ekspertiza për më tepër ka në përmbajtje edhe certifikatën e pronës për ngastrën lëndore, skicën e matjes, ortofotot e viteve përkatëse, fotografitë e vendit të ngjarjes si dhe historiatin e parcelës. Konstatimet e bëra në teren, janë po ato të cilat i ka prezantuar eksperti me ekspertizën e tij gjeodezike e të cilat kanë përputhje të plotë. Palët në procedurë, nuk kishin bërë vërejtje në konstatimin e gjendjes faktike në teren, të cilën e kishte konstatuar gjykata me ndihmën e ekspertit gjeodet Dr.sc. M.L..

Paditësja në shqyrtimin gjyqësor të dt. 15.04.2024 ka deklaruar se: Kam lindur ne fshatin ..., fshati ... ka qene me herët, kam jetuar me babain, nënën, vëllain dhe 6 motra, ne fshatin ... deri ne aktin e martesës ne vitin 1985 me bashkëshortin R.M. i cili ka ndërruar jete ne vitin 2015 ne Gjilan, ku tani regjistrat kadastral kjo evidentohet si ZK- P., kemi jetuar ne një shtëpi e cila ka përmbajtur një ahur dhe pus (bunar) i cili edhe sot është aty, ku edhe shtëpitë janë aty por janë te shkatërruara dhe ne te njëjtat nuk banon askush, sepse janë te shkatërruara dhe te pa rinovueshme, ku edhe gjykata i ka identifikuar këto me dalje ne vend shiqim, nuk mund ta di se kush është pronari aktual sepse letrat kane shkuar ne Serbi gjate kohës se luftës, shtëpitë janë ndërtuar ne vitin 1949. Babai im është vaktedan aty kurse ne këtë lokacion ka ardhur nga

Shqipëria behet fjale për prindin B., babai im ka jetuar deri ne vitin 1987 ne pronën objekt kontesti, ndërsa pas këtij viti nuk ka jetuar askush me ne këtë prone por ne vetëm jemi endur si mysafir, prej para luftës viti nuk me kujtohet me nuk është duke jetuar askush ne ato shtëpi, kurse trashëgimtarët e tjerë te prindit tim sipas meje nuk kane interes ne këtë prone, nuk me kujtohet se a ka pasur kërkesë ne forme te shkruar te babait tim qe ta bart këtë prone ne emrin e tij, po ashtu e njoftoj gjykatën se nuk e di ne emër te kujt sakte prona objekt kontesti është e regjistruar ne regjistrat kadastral te Drejtorisë për Gjeodezi te Komunës se Ferizaj. Ne Gjilan jam duke jetuar nga viti 1985 se bashku me B., Sh. dhe B.M. dhe N.M. Ne vitin 2015 e kam blere nga motra ime S. e cila tani nuk është ne jete e cila ka vdekur qe 5 vite, kam blere pjesën e vet ideale $\frac{1}{2}$ te ngastrës kadastrale, ndërsa detajet e kontratës nuk me kujtohen.

Dëshmitari D.H. në shqyrtimin gjyqësor të dt. 15.04.2024 ka deklaruar se Paditësen e kam teze, kurse nena ime është me e vjetër se teza ime L., nena ime H. ka vdekur para 30 viteve ne fshatin P., nena ime se bashku me tezen dhe fëmijët e tjerë te B. i cili është gjyshi im kane jetuar ne fshatin ..., me sa me kujtohet, aq sa unë e di dhe aq sa unë e mbaj mend prej vitit 1980 deri para luftës se fundit ne Kosove ne vitin 1999, mua nena ime me ka thënë se ata kane jetuar ne një shtëpi edhe para vitit 1980, ndërsa kur janë futur ne shfrytëzim ose posedim te shtëpisë te cilën po e cek nuk e di sepse nuk me kujtohet, pusin e kane pasur ne lokacionin ku gjendet shtëpia dhe me sa kam njohuri gjendet akoma aty dhe me sa me kujtohet probleme nuk kane pasur me askënd, edhe teza ime edhe nena ime janë martuar gjate kohës sa kane qene duke qëndruar ne atë shtëpi, kjo shtëpi ka qene një dhomshe, ka qene e ndërtuar me pallzina e lyer me lloq, me ndryshimet e reja kadastrale prona objekt kontesti figuron te jete pjese e ZK P. ndërsa ne letërnjoftimin dhe ne dokumentet e identifikimit te nënës sime shkruan fshati Qe nga para lufta shtëpia nuk është funksionale, e banueshme, me vit nuk me kujtohet, oborri ka qene i rrethuar me gardh, nga babagyshi B., nuk e di me metër se sa është distanca mes gardhit dhe shtëpisë përkatësisht sipërfaqja, ne si fëmijë te trashëgimtares H. nuk kemi pretendime ne këtë prone. Qe nga pas lufta L. me fëmijët e saj B., N., Sh. dhe B. janë duke jetuar ne Gjilan ne shtëpi, ndërsa B. është duke jetuar aktualisht ne shtëpinë e tij ne Prishtine, tani për tani shtëpia është e pa banueshme, dhe e gjithë parcela realisht tani është bere e pa shfrytëzueshme, aty ka vetëm bari, peme dhe tjera te cilat kanë mbi vetvetiu ne këtë pjese te parcelës, te gjitha këto qe i deklarova dhe qe mi prezantoj gjykata si fotografi janë fakte te gjalla te cilat secili njeri mund ti perceptoj me sytë e tij ne rast se del ne vendin ku gjendet parcela kontestuese.

Dëshmitari F.R. në shqyrtimin gjyqësor të dt. 15.04.2024 ka deklaruar se unë paditësen e njoh përmes babait të saj B., nga shtëpia ku ka jetuar babai i paditëses deri tek shtëpia ime janë diku rreth 500 metra përafërsisht, deri në kur ka ndodhur lufta babai i L. ka jetuar në shtëpinë, me sa e di unë me bashkëshorten e tij, nuk e di se a ka pasur ndonjëherë problem i ndjeri B. i cili nuk e di në cilin vit ka vdekur, por nuk më kujtohet se ka pasur ndonjë problem lidhur me shfrytëzimin e pronës kontestuese, në parcele janë disa therra, disa peme të cilat shihen me sy të lire, nuk e di kush është pronari aktual i regjistruar i parcelës objekt kontesti, nuk kam dëgjuar se ndonjëri prej trashëgimtarëve të të ndjerit B. të ketë pretenduar mbi pronën objekt kontesti. Në parcelat fqinje ose në mëngje me parcelën kontestuese e kanë në posedim pronaret M.H. i cili merret me rregullimin e automjeteve, ndërsa më kujtohet edhe zotëri M. i cili është kufitar me parcelën kontestuese. L. së bashku me fëmijët e saj, njërit fëmijë më kujtohet emri i cili është N. janë duke jetuar momentalisht në Gjilan, mirëpo nuk e di se a janë duke jetuar në shtëpi apo në banesë, nuk më kujtohet prej cilit vit janë shpërngulur për të jetuar në Gjilan nga shtëpia e vjetër në fshatin ..., për momentin kjo pronë është e mbuluar me bari, therra dhe me disa peme, ku aktualisht këto mund të shihen me sy të lire të secilit person. Dëshmitari mund të i identifikoj fotografitë e vendit të ngjarjes pas prezantimit të tyre nga ana e gjykatës.

Përmes deklaratave të dëshmitarëve dhe deklaratës së paditëses gjykata i vërtetoi disa fakte vendimtare në këtë çështje juridiko civile siç janë: se nga deklarata e paditëses vërtetohet se në Gjilan është duke jetuar nga viti 1985 së bashku me B., Sh. dhe B.M. dhe N.M. (fëmijët e saj), babai i saj ka jetuar deri në vitin 1987 në pronën objekt kontesti, ndërsa pas këtij viti nuk ka jetuar askush me në këtë pronë por në vetëm janë endur si mysafir, prej para luftës viti nuk i kujtohet më nuk është duke jetuar askush në ato shtëpi. Poashtu në bazë të deklaratës së paditëses e njëjta kishte deklaruar se nuk e di në emër të kujt sakte prona objekt kontesti është e regjistruar në regjistrat kadastral të Drejtorisë për Gjeodezi të Komunës së Ferizaj. Në bazë të analizës së dëshmitarit D.H. dhe F.R. rezulton se paditësja me fëmijët e saj B., Sh. dhe B.M. dhe N.M. janë duke jetuar në Gjilan nga viti 1985, ndërsa B. është duke jetuar aktualisht në shtëpinë e tij në Prishtinë, tani për tani shtëpia është e pa banueshme, dhe e gjithë parcela realisht tani është bërë e pa shfrytëzueshme, aty ka vetëm bari, peme dhe tjera të cilat kanë mbi vetvetiu në këtë pjesë të parcelës

Zbatimi i së drejtës materiale

Nuk ishte kontestues fakti se pala e paditur në regjistrat kadastral evidentohet si pronare e ngastrës kadastrale me numër 000...-4 ZK P., fakt ky i vërtetuar edhe përmes certifikatës së pronës dhe ekspertizës gjeodezike të ekspertit gjeodet dr. sc. M.L.

Kontestuese ishte fakti, nëse palës paditëse i takon e drejta e pronësisë në ngastrën kontestuese.

Në kuptim të të thënave më lartë, Gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje juridike - kontestimore duhet të zbatohen dispozitat e ligjit material të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore Nr. ...7, dt.30.01.1980 të ish RSFJ. Sipas nenit 20 të këtij Ligji, e drejta e pronësisë fitohet në bazë të veprimit juridik, sipas vetë ligjit dhe me trashëgim, e po ashtu edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe mënyrën e caktuar me ligj. Duke u bazuar në nenin 2.2 të LPK-së, “Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”. Me këtë rast, gjykata konstaton se sipas LMTHPJ-së, nenit 29 është përcaktuar se “Mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrimin fitues.” Në rastin konkret nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronë shoqërore me parashkrim fitues. Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e LMThJP Gazeta Zyrtare RSFJ nr.6/80 (SL.List SRJ, br.29/96) nuk është ligj i zbatueshëm në Kosovë. Pas përfundimit të luftës në Kosovë (vitet 98-99), çështja e legjislacionit në fuqi është e përcaktuar me nenin 1 të Rregullores së UNMIK nr.1999/24, me të cilin është përcaktuar se ligji në fuqi në Kosovë do të jetë: a) rregullorja e shpallur nga PSSP dhe instrumentet e nxjerra në përputhje me të dhe b) Ligjet që kanë qenë të aplikueshme deri me 22.03.1989. Me dispozitën e lartcekur nuk është përcaktuar si ligj i zbatueshëm edhe ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ishin në fuqi me datën 22.03.1989, edhe pse në fuqi mund të janë edhe ligjet pas kësaj date, e të cilat nuk janë diskriminuese dhe që konform me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, gjykata, organi ose personi përjashtimisht mund ta zbatojë atë ligj, në rast se një çështje nuk ka qenë e rregulluar me ligjet e datës 22.03.1989. Siç u tha edhe më lart, për gjykatën, kontestues ishte fakti nëse palës paditëse i takon e drejta e pronësisë në ngastrën kontestuese, ku për vërtetimin e këtij fakti, gjykata ka gjetur se pala paditëse ka dështuar që të provojë faktin se pronën mbi të cilën e pretendon pronësinë të ketë ndonjë titull juridik, ngase dispozitat e parashkrimit fitues nuk mund të aplikohen në këtë rast. Në këtë mënyrë, gjykata konstaton se duke u bazuar në nenin 322.1 dhe 322.2 e lidhur me nenin 319 të LPK-së, barra e të provuarit për faktet e pretenduara i bie palës paditëse. Sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, apo bazës juridike të kërkesëpadisë, sipas

nenit 2.2 të LPK-së, gjykata nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale, por të njëjtën e çmon sipas çmuarjes së lirë. Gjykata me këtë rast vë theksin se në procedurë kontestimore vendos brenda kufijve të kërkesave të palëve, bazuar në nenin 2.1 të LPK-së “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”. Nga gjendja faktike e vërtetuar, gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, gjë të cilën e vlerësoi si konstatim të drejtë, të ligjshëm dhe që i shërben qëllimit të kontestit, pasi që sipas provave të lartcekura nuk u vërtetua se paditëses i takon e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale, me të dhënat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sipas gjendjes KCID azhurnuar të dhënat e viteve 83-88 parc. kad. me nr. ...-1 ZK P. evidentohet në emër të P.SH. KUVENDI KOMUNAL FERIZAJ së paku që nga viti 1983 e tutje, si pronar të ngastrës kadastrale të cekur më lart evidentohet si pasuri shoqërore në emër të të paditurës. Ky fakt vërtetohet edhe nga certifikatat e pronësisë, të cilat janë administruar si prova materiale dhe gjenden në shkresat e lëndës, në të cilat konstatohet se pronare e kësaj ngastrë të cekur si më lart, është e paditura, si pasuri shoqërore. Në anën tjetër, referuar provave të propozuara nga pala paditëse përmes të cilave edhe ka pretenduar se u takon e drejta e pronësisë mbi ngastrën kontestuese në bazë të posedimit me mirëbesim, rezulton se të njëjtat nuk janë bazë e vlefshme për të konstatuar se paditëses i takon e drejta e pronësisë mbi ngastrën kontestuese. Si rrjedhojë, baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses nuk është provuar dhe arsyetuar fare nga pala paditëse, përmes provave materiale konkrete, si rezultat i së cilave edhe ka rezultuar se kërkesëpadia e saj është e pathemeltë. Bazuar në nenin 226 të Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 53/76), Ligjit për Plotësimin e Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 57/83) dhe Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 85/87, ku parashihet se “në qoftë se patundshmëria kalon në pronësi shoqërore pa bazë të vlefshme juridike, pronari e humb të drejtën e pronësisë, në qoftë se nuk e kërkon kthimin e pronësisë në afat prej 5 vjetësh, nga data e marrjes në dijeni, e më së largu në afat prej 10 vitësh”. Kështu që edhe në bazë të këtyre dispozitave, rezulton se edhe nëse do të provohej fakti se e paditura është bërë pronare e ngastrave kontestuese pa ndonjë bazë të vlefshme juridike, paditësja nuk do të mund ta fitonte të drejtën e pronësisë mbi to, për shkak të kalimit të afatit ligjor prej 10 vitësh për të parashtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë (pasi që është provuar fakti se e paditura është e evidentuar si pronare e këtyre ngastrave së paku që nga viti 1983, ndërsa padia nga paditësja është parashtruar në gjykatë në vitin 2021, që do të thotë pas kalimit të 38 viteve). Sigurisht se dispozitat e cekura më lartë do të zbatoheshin në rast se do të provohej se me të vërtetë këtu paditëses i është marr e drejta e pronësisë pa bazë ligjore nga e

paditura. Ndërsa këtë arsytim shtesë gjykata e bëri meqenëse gjykata nuk lidhet për bazën juridike të padisë konform nenit 253.2 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK.

Nga të gjitha të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.311/21, datë 20.05.2024

Gjyqtari,

Armend Ahmeti

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.